

Në bazë të nenit 20 paragrafi (1) nënparagrafët 1 dhe 15¹, dhe në lidhje me nenin 18 paragrafi (1) nënparagrafi 18 të Ligjit për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele („Gazeta Zyrtare e RM-së“ nr.184/13, 13/14, 44/14, 101/14, 132/14, 142/16, 132/17, 168/18, 248/18 dhe 27/19 dhe „Gazeta Zyrtare e RMV-së“ nr.42/20, 77/21, 154/23, 55/24 dhe 193/24), nenet 4, 6, 7, 9, 10 dhe 11 të Ligjit për donacione dhe për sponsorizime në veprimtari publike („Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë“ nr.47/06, 86/08, 51/11, 28/14 dhe 153/15), neni 39 paragrafi (1) nënparagrafët 1 dhe 15 dhe neni 15 paragrafi (1) nënparagrafi 17 të Rregullores së Punës së Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele (Tekst i pastruar) ark.nr.01-3732/1 datë 29.07.2019 dhe Konkluzionin e Këshillit të Agjencisë ark.nr.02-999/3 datë 19.03.2025, Drejtori i Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele miratoi si vijon:

VENDIM

për dhënie të ndihmës financiare - donacion për qytetarët e prekur nga zjarri në Koçan me datë 16.03.2025

1. I ndahet ndihmë financiare – donacion në shumë të përgjithshme prej 1.500.000,00 (një milion e pesëqind mijë) denarë, si ndihmë për qytetarët e prekur nga fatkeqësia e tmerrshme – zjarri i cili ndodhi në Koçan me datë 16.03.2025, që do të realizohet përmes Kryqit të Kuq të Republikës së Maqedonisë së Veriut, si pranues i donacionit.

Pranuesi i donacionit do t'i shpërndajë mjetet financiare nga paragrafi (1) i kësaj pike, sipas nevojave të qytetarëve të prekur nga zjarri në Koçan.

2. Mjetet financiare nga pika 1 e këtij Vendimi, ndahen nga mjetet financiare të Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele (në tekstin e mëtejshëm: Agjencia) për vitin 2025 dhe janë të parapara me Planin Financiar të Agjencisë për vitin 2025, dhe pagohen në llogari të posaçme të Kryqit të Kuq të Republikës së Maqedonisë së Veriut – Fondi i solidaritetit banka Komerciale SHA Shkup, llogari numër 300000001327966, numri tatimor: 4030984271620, me shënim: ndihmë për qytetarët e prekur nga zjarri në Koçan.

3. Për dhënien e ndihmës financiare – donacion nga pika 1 e këtij Vendimi, lidhet Kontratë për donacion ndërmjet Agjencisë dhe Kryqit të Kuq të Republikës së Maqedonisë së Veriut, që hyn në fuqi menjëherë pas nënshkrimit nga të dy palët kontraktuese dhe do të realizohet pas marrjes së mendimit pozitiv për interesin publik nga Ministria e Drejtësisë së Republikës së Maqedonisë së Veriut.

4. Ky Vendim hyn në fuqi me miratimin e tij dhe do të publikohet në ueb faqen e Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele.

A r s y e t i m

Në bazë të nenit 20 paragrafi (1) nënparagrafët 1 dhe 15, dhe në lidhje me nenin 18 paragrafi (1) nënparagrafi 18 të Ligjit për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele, nenet 4, 6, 7, 9, 10 dhe 11 të Ligjit për donacione dhe sponsorizime në veprimtari publike, neni 39 paragrafi (1) nënparagrafët 1 dhe 15 dhe neni 15 paragrafi (1) nënparagrafi 17 të Rregullores së Punës së Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele dhe Konkluzionin e Këshillit të Agjencisë, ark.nr.02-999/3 datë 19.03.2025, Drejtori i Agjencisë miratoi vendim për dhënien e ndihmës financiare – donacion në shumë të përgjithshme prej 1.500.000,00 (një milion e pesëqind mijë) denarë si ndihmë për qytetarët e prekur nga fatkeqësia e tmerrshme – zjarri i cili ndodhi në Koçan me datë

¹ Nënparagrafët 8 dhe 9 janë fshirë, shih: neni 8 të Ligjit për ndryshimin dhe plotësimin të Ligjit për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele („Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë“ nr.248/18)

16.03.2025, që do të realizohet përmes Kryqit të Kuq të Republikës së Maqedonisë së Veriut, si pranues i donacionit. Pranuesi i donacionit do t'i shpërndajë mjetet e dhëna financiare, sipas nevojave të qytetarëve të prekur nga zjarri në Koçan. Mjetet e dhëna financiare nga pika 1 e këtij Vendimi, do të ndahen nga mjetet financiare të Agjencisë për vitin 2025 dhe janë të parapara në Planin Financiar të Agjencisë për vitin 2025, dhe pagohen në llogari të posaçme të Kryqit të Kuq të Republikës së Maqedonisë së Veriut – Fondi i solidaritetit, banka Komerciale SHA Shkup, llogari numër 300000001327966, numri tatimor: 4030984271620, me shënim: ndihmë për qytetarët e prekur nga zjarri në Koçan. Për lëndën, dhënie ndihmë financiare, lidhet Kontratë për donacion ndërmjet Agjencisë dhe Kryqit të Kuq të Republikës së Maqedonisë së Veriut, që hyn në fuqi menjëherë pas nënshkrimit nga të dy palët kontraktuese, dhe do të realizohet pas marrjes së mendimit pozitiv për interesin publik nga Ministria e Drejtësisë së RMV-së.

Ky Vendim hyn në fuqi me miratimin e tij dhe do të publikohet në ueb fqen e Agjencisë.

Bazuar në sa më sipër u miratua vendim si në dispozitiv.

**Agjencia për Shërbime Mediatike
Audio dhe Audiovizuele
Drejtori,
Dr. Zoran TRAJÇEVSKI**